REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 499 Prot

Maliq, më 02.02.2026

VENDIM
Nr. 14, datë 30.01.2026

PËR
"MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR , PËR VITIN 2026"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 24, pika 1, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/ 2015, "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar, ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë, vendimit nr. 597, datë 22.07.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuar, pikës 2, të udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për përfitimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

I. Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit nga buxheti vendor , për vitin 2026 për bllok-ndihmën ekonomike deri në 3 për qind, si më poshtë:

1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet regjistrit elektronik për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit ose nga fondi 6%.
2. Do të përzgjidhen ata aplikues që kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni.
3. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht nga punonjësi social dhe administratorët shoqërorë të njësisë përkatëse.
4. Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
5. Familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
6. Familje të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, me probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin etj.) të cilët kanë vështirësi punësimi.
7. Familje Rome dhe Egjiptiane të cilat kanë probleme me transferimin dhe regjistrimin.
8. Familjet me një anëtar që nuk kanë të ardhura ose i kanë të pamjaftueshme.
9. Familje me anëtar në moshë mbi 60-vjet, të cilët kanë në përbërje anëtar mbi moshë pune përfitues të një pensioni pleqërie.
10. Familje në varfëri ekstreme në rast fatkeqësie në pamundësi të përballimit të shpenzimeve.
11. Rastet kur k/familjari ose edhe anëtarë të tjerë madhorë janë të paaftë për të punuar,por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesë P.A.K.

II. Të miratojë procedurat mbi përdorimin e fondit nga buxheti vendor për bllok-ndihmën ekonomike deri në 3 për qind, si më poshtë:

1. Njësitë Administrative përpunojnë listën e përfituesve të mundshëm dhe vlerësojnë dosjet për t'u trajtuar me këto fonde.
2. Njësitë Administrative dërgojnë çdo muaj pranë Drejtoria e Shërbimit Social listën e përfituesve të mundshëm për të përfituar nga ky fond.
3. Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror harton projekt-vendimin për familjet në nevojë, në bazë të propozimeve të ardhura nga Njësitë Administrative, për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor deri në 3 për qind.

III. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar.

Miratuar me 22 vota
Vota Pro 22
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.02.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ